

OFERTA PËR EKSKURSION (Tre netë e katër ditë)

Gjimnazi "Naim Frashëri" në Shtime, organizon Ekskursion bazuar në UA 02/2016, me të cilin rregullohet çështja e Ekskursionit, Neni 11, pika 1 dhe 2.

Itinerari i paraparë për realizim është si vijon:

Dita parë 25 prill 2023;

- Ora 7:00 nga Shtimja bëhet nisja për Shqipëri.
- Vizitë qytetit të Lezhës (te varri i Skënderbeut), duke vazhduar më pas në Shkodër dhe Shirokë – vizitë Pedonale së qytetit. Dreka duhet të jetë në qytetin e Shkodrës, sasia e ushqimit dhe e bukës të jetë e freskët dhe e mjaftueshme për secilin nxënës nga kompania kontraktuese. Në ofertë të jenë të specifikuar menyuja që ofron.
- Kthimi në hotel në Durrës dhe sistemimi nëpër dhoma gjumi. Dhomat të pajisura jo më shumë se tre shtretër. Secila dhomë të ketë banjën e vet me ujë të ngrohtë gjatë gjithë kohës. Mbulesa të pastërta dhe të mjaftueshme.

Dita dytë 26 prill 2023;

- Mëngjesi në ora 07:00-08:30. Sipas menysë e cila rëndomtë shtrohet në mëngjes: Ushqim, pije të ngrohta dhe sasi e mjaftueshme e bukës.
- Vizitë: Nisja në ora 09:00 për në qytetin e Krutës, përkatësisht në Muzeun Kombëtar "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu", pagesa për hyrje bëhen nga kompania kontraktuese.
- Kthimi në hotel për drekë. Sasia e ushqimit dhe e bukës të jetë e freskët dhe e mjaftueshme për secilin nxënës. Ushqimi të jetë kualitativ dhe kalorik. Vizitë qytetit të Tiranës. Darka: 20:00-21:00. Sasia e ushqimit dhe e bukës të jetë e freskët dhe e mjaftueshme për secilin nxënës. Ushqimi të jetë kualitativ dhe kalorik.

Dita tretë 27 prill 2023;

- Mëngjesi në ora 07:00-08:30. Sipas menysë e cila rëndomtë shtrohet në mëngjes: Ushqim, pije të ngrohta dhe sasi e mjaftueshme e bukës.
- Vizitë në qytetin e Vlorës, përkatësisht në Shtëpinë e Pavarësisë. Nisja në ora 09:00. Pagesa për hyrje në Shtëpinë e Pavarësisë bëhet nga kompania kontraktuese.
- Dreka në Vlorë: Jo ushqim i shpejtë, por i njëjtë sikur në Hotelin e akomoduar.
- Darka: 19:00-20:30. Sasia e ushqimit dhe e bukës të jetë e freskët dhe e mjaftueshme për secilin nxënës. Ushqimi të jetë kualitativ dhe kalorik.
- Mbrëmje argëtuese: 21:00-00:00. Muzikë live ose DJ sipas dëshirës së nxënësve. Mbrëmja mbaron në ora 00:00.



Dita katërt 28 prill 2023;

- Mëngjesi në ora 07:00-08:30. Sipas menysë e cila rëndomtë shtrohet në mëngjes: Ushqim, pije të ngrohta dhe sasi e mjaftueshme e bukës.
- Vizitë: Nisja në ora 09:00 për në qytetin e Beratit, kthimi në hotel për drekë. Sasia e ushqimit dhe e bukës të jetë e freskët dhe e mjaftueshme për secilin nxënës. Ushqimi të jetë kualitativ dhe kalorik. Kthimi për Kosovë.

Bartja e nxënësve (afërsisht 150-189) bëhet me autobusë nga agjenci turistike sipas relacioneve të lartpërmendura, ndërsa akomodimi dhe qëndrimi bëhet në hotel (Durrës). Akomodimi gjatë qëndrimit përfshin: fjetjen, sigurinë fizike dhe shëndetësore (24 orëshe). Ushqimin cilësor, kalorik dhe i bollshëm.

Ndërkohë, Agjencioni duhet t'i përmbahet të gjitha obligimeve që dalin nga UA 02/2016.

Hoteli duhet të jetë i përshtatshëm. Me jo shumë kate. Nëse ka më shumë se tri kate të posedojë ashensor. Staf i Hotelit duhet të sigurojë pastërti të ambientit ku qëndrojnë dhe argëtohen nxënësit. Hoteli duhet të sigurojë po ashtu çmime të njëjta të produkteve të tjera (pos atyre që janë në kontratë) me të njëjta çmime që janë edhe jashtë hotelit.

Në këtë ofertë mund të konkurrojnë të gjitha agjencitë, të cilat i plotësojnë këto parakushte:

- Të kenë licencën sipas Ligjit mbi Transportin,
- Të kenë bërë dëshmi mbi kontrollin teknik sipas procedurave ligjore dhe teknike,
- Të kenë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevoja të shkollës,
- Autobusët të jenë komfor dhe me kondicioner,
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin psiko-fizik të ngasësëve,
- Agjencioni duhet t'i ketë fotokopje librezat e autobusëve,
- Të përkrahë nxënësit me shërbime mjekësore si dhe dëshminë e certifikatës së punës së mjekut,
- Agjencioni duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve,
- Në bashkëpunim me hotelin e mundshëm, nxënësve dhe personelit përcjellës, t'iu ofrohet siguria 24 orëshe.
- Kolona e autobusëve të jetë e harmonizuar dhe të mos ketë ndarje (lëvizje e autobusëve një pas një).
- Itinerari të respektohet në mënyrë strikte, ndërsa ndryshimet eventuale mund t'i bëjë në marrëveshje të plotë me drejtorin e shkollës.

Afati i paraqitjes me të gjitha dëshmitë dhe dokumentacionin është shtatë (7) ditë nga dita e publikimit në tabelën e njoftimeve në shkollë dhe web-faqe zyrtare të Komunës së Shtimes.

Ofertat do të hapen pas skadimit të afatit për ofertim. Ofertuesi i përzgjedhur nga komisioni i merr të gjitha obligimet sipas UA nr. 02/2016, përkatësisht neni 11.

